



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.01, datë 02.04.2024

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
LIBRAZH, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 10, DATË 08.02.2017
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 10, datë 08.02.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Librazhd”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 123, datë 29.12.2023, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Librazhd, të miratuar me Vendimin Nr. 10, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, të bëhen ndryshime në:
 - *Dokumentin e Rregullores së Planit:*
 - Neni 43/2 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”, ndryshohet;
 - Pas nenit 43/2 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”, shtohet Neni 43/3 “Kushte për objektet ekzistuese në sistemin bujqësor dhe natyror”;
 - Pas nenit 43/3 “Kushte për objektet ekzistuese në sistemin bujqësor dhe natyror”, shtohet neni 43/4 “Burimet ujore”;
 - Neni 59/1 “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm”, ndryshohet;
 - Në nenin 61 “Kushtet e përgjithshme të ndarjes së parcelave për qëllime zhvillimi”, pas gërmës i) shtohen gërmat: j), k) dhe l);
 - Pas nenit 62 “Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse”, shtohet neni 62/1 “Madhësia minimale e parcelës”;

YILLI I MINISTR

- Pas nenit 68 "Aksesi", shtohen nenet 68/1 "Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C" dhe 68/2 "Hekurudhat";
- Në nenin 73 "Përcaktimi i vijës blu - vija mbrojtëse përgjatë elementeve ujore", pikat 5, 6, dhe 7 ndryshohen dhe pas pikës 7, shtohen pikat 8, 9 dhe 10;
- Pas nenit 73 "Përcaktimi i vijës blu - vija mbrojtëse përgjatë elementëve ujorë", shtohet neni 73/1 "Kanalet vaditëse/Emisaret";
- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Librazhd dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Librazhd, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I INFINJES
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

